

VENDIM
Nr. 27, datë 6.2.2020

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KOMISIONIT KOMBËTAR RREGULLATOR
NR. 5, DATË 3.2.2017, "PËR LICENCIMIN E SHA UJËSJELLËS-KANALIZIME
POGRADEC"

Në mbështetje të nenit 13, 14, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", të ndryshuar (ligji nr. 8102), VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009, "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë" (VKM-ja nr. 958), si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009, "Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", të ndryshuar (Rregullore e licencimit),

Komisioni Kombëtar Rregullator,

në mbledhjen e datës 6.2.2020, pasi shqyrtoi çështjen me objekt: "Mbi miratimin e projektvendimit "Për një ndryshim në vendimin e Komisionit Kombëtar nr. 5, datë 3.2.2017, "Për licencimin e sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Pogradec",

VËREN SE:

1. Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Pogradec (UK Pogradec), me shkresën nr. 43 prot., datë 23.1.2020, me lëndë "Shkresë përcjellëse" ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) kërkesën për rinovim të licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor, të shoqëruar me dokumentacionin sipas përcaktimeve të parashikuara në VKM-në nr. 958 dhe në Rregulloren e Licencimit.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës së UK Pogradec, për rinovim licence për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor, në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM-në nr. 958 dhe në Rregulloren e Licencimit.

3. KKRR-ja ka licencuar shoqërinë UK Pogradec me vendimin nr. 5, datë 3.2.2017, "Për licencimin e sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Pogradec, me një afat 4-vjeçar, ku shoqëria autorizohet të ofrojë shërbimin e grumbullimit dhe shpërndarjes së ujit për konsum publik, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura.

4. Drejtuesi ligjor i shoqërisë UK Pogradec sh.a., z. Johan Sterjo, ka mbaruar studimet e larta në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë, në degën Histori.

5. ERRU, në vlerësimin e kërkesës për ndryshimin e licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor, ka marrë në konsideratë përmblotjen nga ana e UK Pogradec sh.a. të kërkesave të ligjit nr. 8102, të VKM-së nr. 958 dhe të Rregullores së Licencimit, në mënyrë të veçantë sa i takon garantimit që i licencuari të veprojë në përputhje me kushtet e licencës së tij dhe të mbrojë interesat e konsumatorëve në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se aplikimi i UK Pogradec është i bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Në pikën 1, të vendimit të KKRR-së nr. 5, datë 3.2.2017, "Për licencimin e sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Pogradec", bëhen këto ndryshime:

“Drejtues Ligjor: z. Johan Sterjo”
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani